



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:076926

Datë: 18.05.2021

Numri i dokumentit: 01789264

C.nr.998/18

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Venhar Salihu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G. S. nga Gjilani, të cilin e përfaqëson me autorizim av.Shabi Isufi avokat nga Gjilani, kundër të paditurës FINCA Kosovë, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit, me datë 18.05.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Padia e paditësit G. S., e paraqitur kundër të paditurës FINCA Kosovë, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e dëmit, **KONSIDEROHET E TËRHEQUR.**

II. Paditësi G. S. i bartë shpenzimet e veta të krijuara në këtë procedurë, kurse të paditurës Finca Kosovë, i njëjti obligohet t'i paguaj shumën prej 135€.

A r s y e t i m i

Pranë kësaj gjykate me dt.22.02.2019 paditësi ka paraqitur padi kundër të paditurës me objekt kontesti kompensimin e dëmit.

Gjykata në lidhje me këtë çështje ka caktuar seancë të shqyrtimit gjyqësor për datë 18.05.2021 në fillim në ora 13:15, ku ftesë në mënyrë të rregullt i ka dërguar palëve ndërgjyqëse, përkatësisht i ka dërguar përfaqësuesit të paditësit Shabi Isufi avokat nga Gjilani dhe të paditurës.

Në seancën e lartcekur nuk ka prezantuar përfaqësuesi i paditësit edhe për kundër faktit se ftesën e ka pranuar (fakt ky i vërtetuar nga flete kthesa), dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar.

Në seancën e lartcekur, përfaqësuesi i të paditurës ka prezentuar dhe i njëjti ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr dhe ka kërkuar ½ e shpenzimeve, edhe atë në shumë prej 135€ për pjesëmarrje në seancën e lartcekur.

Me që ne rastin konkret paditësi, përkatësisht i autorizuari e tij është ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, atëherë gjykata duke e zbatuar nenin 409 lidhur me nenin 387.1, nën pika c) të LPK-së, vendosi si në pikën I të dispozitivit.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit duke u bazuar në nenin 450 dhe 452.1 të LPK-së, dhe detyroi paditësin që të paditurës të i paguaj shumën prej 135€ edhe atë ½, për shkak se seanca e lartcekur nuk është mbajtu, kurse sa i përket shumës së aprovuar,

gjkata u bazua në TA për avokatë, për shkak se në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit ka qenë shuma prej 36.000.00 dhe në bazë të tarifës për një seancë duhet të paguhet shuma prej 270 € , por në rastin konkret seanca nuk është mbajtur por është konsideruar si e tërhequr padia e paditësit.

Andaj, nga të lartcekurat duke përfshirë dispozitën ligjore në njërën anë, kurse në anën tjetër duke u bazuar në nenin 387.1, nën pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjyqtari
Venhar Salihu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 dite, në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet për mes kësaj gjykate.